



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:266929  
Datë: 09.12.2021  
Numri i dokumentit: 02490856

**A.nr.1548/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**/Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me zyrtaren ligjore Besë Sylaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, B....F....F....., me adresë vendbanimi në Rr. "M.... T....", nr. ..., Komuna e P..., kundër të paditurës, M...P...M...S.....-Departamenti i Administratës P... të Republikës së Kosovës në Prishtinë,, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palës ndërgjyqëse, me datë 02.12.2021, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** kërkesëpadia e paditëses, B....F....F....., nga Komuna e P..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi me numër të dosjes 6014144 i datës 01.02.2019, i të paditurës M...P...M...S.....-Departamenti i Administratës P... të Republikës së Kosovës në Prishtinë dhe të urdhërohet e paditura që t'i miratoj kërkesën e paditëses për njohjen e të drejtës në presionin me pa aftësi të kufizuar së përhershme, nga dita e paraqitjes së kërkesës, si e **pa bazuar**.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA -së, në mungesë të palës paditëse e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: fletë- kthesa e datës 17.11.2021), dhe në mungesë të palës së paditur (Provë: fletë-kthesa e datës 12.11.2021).

Paditësja, B.... F.... në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 01.07.2019, ka kërkuar që "të aprovohet si e bazuar padia e paditëses për anulimin e vendimit me nr. të dosjes 6014144 të datës 01.02.2019 të M...P...M...S.....-Departamenti i Administratës P... në Prishtinë si të kundërligjshëm dhe Gjykata të miratojë kërkesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension me aftësi të kufizuar të përhershme dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës, ashtu që të urdhërohet e paditura, M...P...M...S.....- Departamenti i Administratës P... në Prishtinë, që në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi të nxjerr aktvendim bazuar në këtë aktgjykim."

E paditura, në përgjigjen në padi të parashtruar me datë 17.06.2021, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar duke theksuar se: M...P...M...S.... nga Komisioni ekspert mjekësorë nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, kanë vlerësuar dokumentacionin në tërësi, ku për baze kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësorë si dhe raportet nga specialistet, ku është konstatuar se paditësi nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuar të plote dhe të përhershme siç përcaktohet sipas dispozitave ligjore për personat me aftësi të kufizuar ashtu që i propozon gjykatës që të refuzon kërkesë padinë e paditëses, B....F..., me adresë vendbanimi në Rr. "M.... T....", nr. ..., Komuna e P..., në tërësi si të pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi me nr. te dosjes 6014144 të datës 01.02.2019.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor – publik të datës 02.12.2021, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i M...P...M...S....- i datës 01.02.2019; raport nga konsulta i datës 22.10.2018; udhëzim për konsultim i datës 13.08.2018; udhëzim për konsultim i datës 23.03.2016; udhëzim për konsultim i datës 20.09.2018; udhëzim për konsultim i datës 07.08.2018; udhëzim për konsultim i datës 20.07.2018; raport nga konsulta i datës 24.08.2018; raport nga konsulta i datës 25.09.2015; udhëzim për konsultim i datës 04.05.2016; raport nga konsulta i datës 04.05.2016; udhëzim për konsultim i datës 17.09.2015; raport nga konsulta i datës 15.08.2018; raport nga konsulta i datës 10.08.2018; raport nga konsulta i datës 21.09.2018; raport nga konsulta i datës 25.03.2016; vendimi i datës 01.02.2019; vendimi i datës 23.10.2018; ankesa e protokolluar me datën 12.11.2018 me nr. 450; udhëzim për konsultim i datës 20.07.2018; raport nga konsulta i datës 24.08.18; raport nga konsulta i datës 22.10.2018; raport nga konsulta i datës 04.05.2016; raport nga konsulta i datës 25.09.2015; raport nga konsulta i datës 15.08.2018; raport nga konsulta i datës 21.09.2018; vlerësimi i komisionit mjekësor – konstatimi i komisionit mjekësor i datës 22.10.2018; rivlerësimi i datës 10.01.2019 dhe shqyrtimi i ankesave i datës 10.01.2019.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestuese komfor Nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) – Ligji Nr. 03/L-202, gjykata në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **pa bazuar**.

Me vendimin e organit të shkallës së parë të paditurës, të datës 23.10.2018 gjykata gjen se, është refuzuar kërkesa e paditësit për njohjen e të drejtës në Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar, pasi që Komisioni Mjekësor i shkallës së parë i datës 22.10.2018, ka vlerësuar se tek paditësi aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme, nuk ekziston.

Me vendimin organi të shkallës së dytë të së paditurës, të goditur me padi është refuzuar ankesa e paditëses për njohjen e të drejtës në Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar me arsyetimin se Komisioni në shkallë të dytë në seancën e datës 10.01.2019, pasi ka vlerësuar në tërësi shkresat lendes, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor si dhe vlerësimin e komisionit të shkallës së parë në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 për PAK, ka arritur në përfundimin se të paditësi nuk ka dokumentacion mjekësorë të mjaftueshëm për të qenë përfitues i Pensionit për Persona me aftësi të përhershme, dhe se pajtohet me vlerësimin e komisionit të shkallës së parë se nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj.

Kjo gjykatë duke vlerësuar ligjshmërinë aktvendimit kontestues ka konstatuar se, organet administrative, drejtë kanë zbatuar dispozitën e Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, respektivisht nenin 9, paragrafin 5 të tij në bazë të të cilit edhe është refuzuar kërkesa respektivisht ankesa e paditësit, që t'i njihet e drejta në Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar meqenëse ankuesi para komisioneve mjekësorë nuk i ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që dëshmon se i plotëson kriteret e përcaktuara të ligjit në zbatim.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit se nuk është vlerësuar drejt gjendja shëndetësore e tij mirëpo të njëjtat si të tilla në këtë çështje administrative nuk i ka ofruar dëshmi në një vendosje tjetër nga ajo që ka vendosur organi i paditur sepse nga provat e administruara gjykata në kuptim të dispozitës nenin 9, paragrafi 5 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, vërtetohet se paditura ka vërtetuar drejt gjendjen faktike pasi paditësi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme para komisionit në shkallës së dytë me ankesë për të dëshmuar se ka plotësuar kushtin ligjor të përcaktuar që kërkohet për njohjen kësaj të drejte .

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditëses të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se paditësja të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin me ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetojë një tjetër të gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur.

Nga kjo gjendje e konstatuar si me lart, gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike e zbatuar ligjin material, kur kanë refuzuar ankesën e paditëses B... (F....) F.... nga P...., si të pabazuar. Andaj, mbi këto arsye kjo

gjykatë kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoj sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.parg.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.1548/19- datë: 02.12.2021**

Zyrtare ligjore  
Besë Sylaj

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.